



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE  
BORDI**

**VENDIM**

**Nr. 105, datë 31.05.2019**

**PËR  
REFUZIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË “PROGRESSIG” SH.A. PËR  
LICENCIMIN E USHTRIMIT TË VEPRIMTARISË SË SIGURIMIT NË KLASAT E  
JO-JETËS NË TERRITORIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, mbështetur në nenin 14, pika 4, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, dhe pas shqyrtimit të relacionit të Departamentit të Mbikëqyrjes së Tregut të Sigurimeve/Zyra e Licencimit,

**KONSTATOI SE:**

Shoqëria “Progressig” sh.a., depozitoi në AMF kërkesën dhe dokumentacionin për licencimin e ushtrimit të veprimtarisë së sigurimit në klasat e Jo-Jetës në territorin e Republikës së Shqipërisë, me shkresat e datave 22.10.2018 dhe 31.10.2018 (protokolluar në AMF me nr. 3581 prot., datë 22.10.2018 dhe nr. 3685 prot., datë 31.10.2018).

Në bazë të nenit 29, të Ligjit nr. 52/2014, në fazën e miratimit paraprak të shqyrtimit të kërkesës dhe dokumentacionit të shoqërisë “Progressig” sh.a., Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv ngriti Grupin e Punës me Urdhrin nr. 16, datë 17.01.2019.

Në zbatim të pikës 4, të nenit 32, të Ligjit nr. 52/2014 dhe me shkresën nr. 329 prot., datë 25.01.2019, shoqërisë iu komunikua plotësimi brenda 1 muaji, i dokumentacionit që mungonte:

- a. Vërtetim që kapitali minimal fillestar është paguar në një llogari të veçantë garancie në një bankë të nivelit të dytë në Republikën e Shqipërisë;
- b. Vërtetim që shoqëria e sigurimit ka ngurtësuar fond shtesë për shpenzime nisjeje në një llogari të veçantë garancie në një bankë të nivelit të dytë në Republikën e Shqipërisë, që do të përdoret për të mbuluar shpenzimet e themelimit, funksionimit dhe administrimit dhe nuk duhet të jetë më i vogël se 5% e kapitalit minimal fillestar;

- c. Në bazë dhe për zbatim të kërkesave të neneve 17 dhe 20, të Ligjit nr. 52/2014, për përshtatshmëri dhe aftësi të anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës (KM), Administratorit (AD) të shoqërisë, dokumente që vërtetojnë informacionin e dhënë në CV, lidhur me arsimin e lartë, “Master” në fushat e përcaktuara nga Ligji, dokumentacion për përvojën në sigurime, letra rekomandimi nga punëdhënësit e mëparshëm si dhe çdo dokument tjetër që të tregon që aplikantët i plotësojnë këto kërkesa;
- d. Projekt-kontratat për delegimin e funksioneve të veçanta të veprimtarisë së shoqërisë së sigurimit, në qoftë se shoqëria ka planifikuar delegime të tilla;
- e. Dokument bankar që vërteton kryerjen e pagesës së tarifës së aplikimit për pajisjen me licencë si shoqëri sigurimi, sipas nivelit të përcaktuar në Rregulloren nr. 155, datë 23.12.2014 “Për përcaktimin e elementeve të përlllogaritjes dhe nivelet e tarifave që u ngarkohen subjekteve të mbikëqyrura, si dhe procedurat e arkëtimit dhe rakordimit të tyre”, e ndryshuar.

Shoqëria aplikuese depozitoi brenda afatit ligjor, me shkresën e datës 26.02.2019, (protokolluar në AMF nr. 329/1 prot., datë 27.02.2019) një pjesë të dokumentacionit të cituar më lart (shkronja “c” dhe “d”, mbetën ende pa plotësuar pikat “a”, “b” dhe “e”.

Në të njëjtën shkresë me depozitimin e dokumentacionit më sipër, shoqëria aplikuese kërkonte që AMF t’i vinte në dispozicion leje për hapjen e llogarisë qëllimore pranë një banke të nivelit të dytë në Republikën e Shqipërisë, sepse nga kontaktet me bankat, shoqërisë i ishte kërkuar leja, si domosdoshmëri për ngurtësimin e kapitalit fillestar dhe fondit shtesë.

Me shkresën nr. 329/2 prot., datë 11.03.2019, iu kërkuar shoqërisë plotësimi i dokumentacionit që mungonte, si dhe të mangësive në dokumentacionin e depozituar më parë në AMF, mangësi që rezultuan nga ballafaqimi i dokumentacionit të depozituar me kërkesat e nenit 30, të Ligjit nr. 52/2014. Afati i depozitimit të tyre në AMF ishte deri në 15.04.2019. Me këtë shkresë, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare sqaronte shoqërinë për:

- Fondin e garancisë dhe shpenzimet e nisjes, bazuar në kërkesat e përcaktuara në nenin 81 të Ligjit nr. 52/2014, sipas të cilit fondi i garancisë duhet:
  - Të mbahet në një llogari bankare qëllimore të quajtur “llogaria e fondit të garancisë”, në një nga bankat dhe/ose degët e bankave të huaja në territorin e R.Sh.;
  - Të investohet vetëm në bono thesari dhe/ose depozita bankare, me afat maturimi jo më të vogël se 1 vit dhe të ketë përshkrimin që “nuk mund të preket pa miratimin paraprak të Autoritetit”;
  - Gjithashtu në zbatim të nenit 13, të Ligjit nr. 52/2014, shoqëria e sigurimit duhet të ketë edhe një fond shtesë, për shpenzime nisjeje, i cili nuk duhet të jetë më i vogël se 5% e kapitalit minimal fillestar.
- Investimin e fondit të garancisë, në zbatim të kërkesave të Rregullores nr. 86, datë 03.07.2017 “Mbi administrimin e fondit të garancisë së shoqërisë së sigurimit dhe rastet e ndërhyrjes”, investimi i fondit të garancisë:
  - Kur është në monedhë të huaj nuk duhet të kalojë 30% të vlerës së tij;
  - Investimet e fondit në një bankë të vetme nuk duhet të tejkalojnë vlerën 25% të tij;
  - Bonot e thesarit dhe depozitat për fondin e garancisë përmbajnë kushtin që “nuk mund të preken pa miratimin paraprak të AMF-së”;

- Brenda 5 ditëve kalendarike nga kryerja e investimit të fondit të garancisë në bono thesari dhe depozita bankare mbi 1 vit, shoqëria e sigurimit njofton AMF për investimet e kryera dhe depoziton dokumentet që vërtetojnë kryerjen e tyre.
- Burimin e kapitalit, në zbatim të kërkesës së pikës 3, të nenit 16, të Ligjit nr. 52/2014, shoqëria të deklarojë dhe vërtetojë me dokumentacion se kontributet për kapitalin e saj nuk burojnë nga fonde të marra hua nga publiku, kredi bankare, hua të tjera, nga fonde, origjina e të cilave është e paligjshme, ose paradhënie të paguara nga palë të treta.
- Çështjet aktuariale, në zbatim të kërkesave të pikave I, 13.b), paragrafët ii) dhe iii) dhe pikës II, të nenit 30, të Ligjit 52/2014 shoqëria e sigurimit duhet:
  - Të depozitojë projekt-kontratat që mungojnë, për produktet e përfshira në klasën 10 të sigurimit, sipas përcaktimeve të aneksit I, bashkangjitur Ligjit 52/2014, përfshirë kushtet e përgjithshme, të veçanta të kontratës së sigurimit, në përputhje me klasën e sigurimit, për të cilën ka kërkuar të licencohet;
  - Të përshkruajë bazën teknike të të dhënave të përdorura për llogaritjen e primit dhe të elementeve e parametrave të planifikuar për llogaritjen e primit, përfshirë tabelat e primit;
  - Të depozitojë opinionin e aktuarit të autorizuar në lidhje me të dhënat e përshkruara si dhe llogaritjet e primeve të riskut dhe sigurimit për produktet që shoqëria pritet të ofrojë në treg.
- Në zbatim të kërkesës së pikës 1a) të nenit 4, të Rregullores nr. 155, datë 23.12.2014, e ndryshuar, shoqëria detyrohet të paguajë tarifën 20.000 lekë, për depozitim e shqyrtim dokumentacioni në momentin e depozitimit të dokumentacionit në Autoritet.

Në AMF nuk u depozitua dokumentacioni i plotë sipas kërkesave ligjore brenda afatit të kërkuar në shkresë. Shoqëria nuk ka respektuar kërkesat e nenit 13, të Ligjit 52/2014, nenit 30, pika 4, lidhur me depozitimin e fondit të garancisë (370.000.000 lekë) dhe shpenzimeve të nisjes, si edhe ka shkelur afatin 1 mujor të depozitimit të plotësimit të dokumentacionit të kërkuar ligjor.

Për sa më sipër në përfundim të shqyrtimit, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, bazuar në nenin 14/4, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, mbështetur në nenin 32/4/5, nenin 34/1 të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”,

## **V E N D O S I:**

1. Refuzimin e kërkesës së shoqërisë “Progressig” sh.a., për licencimin e ushtrimit të veprimtarisë së sigurimit në klasat e Jo-Jetës në territorin e Republikës së Shqipërisë.
2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes së Tregut të Sigurimeve për njoftimin në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR**  
**Pajtim MELANI**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV**  
**Ervin KOÇI**